

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

11.02.2025

Ora 15:08

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 02 shkurt – 08 shkurt 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. I. Osmanaj

Parti Politike: Nuk ka prezent

Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend të ditës për të shqyrtuar raportin mbi veprimtaritë publike të institucioneve për periudhën 2-8 shkurt. Kemi shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 3, datë 3.02.2025 të regjistrit të denoncimeve të organizatës “Qëndresa Qytetare”. Shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 4, datë 6.02.2025 të regjistrit të denoncimeve të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara. Kemi shqyrtimin e raportit të monitoruesve të fushatës për periudhën e monitorimit 2-9 shkurt 2025 si dhe projektvendimin për plotësim vakance në këshillin e Bashkisë Gjirokastrë. Fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, ka të bëjë me raportin për veprimtaritë publike të institucioneve publike për periudhën 2-8 shkurt 2025. Po Pavlina.

Znj. P. Doçaj: Faleminderit! Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike, në ndërfaqen e raportimeve të institucioneve NRI për periudhën 2-8 shkurt, konsistohet

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

si vijon: 8 institucione publike të regjistruara gjatë kësaj periudhe në ndërfaqe dhe kanë akses për raportimet e veprimtarive të tyre, 313 raportime janë kryer në total për këtë periudhë, 310 postime janë aktive dhe dy janë postime të cilat janë ndaluar nga vetë sistemi NRI, për shkak të raportimit jashtë afatit të përcaktuar. Pikërisht kemi dy drejtori, Drejtoria Vendore e Policisë së Lezhës dhe Drejtoria e Prefektit të Qarkut Shkodër, të cilat kanë deklaruar 2 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar. Vlerësojmë se duhet të fillohet procedimi administrativ për këto dy institucione.

Vendimi nr. 76

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

11.02.2025

Ora 15:10

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 3, datë 03.02.2025,
të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj.L. Veliu, znj. I. Osmanaj
- Parti Politike:** Nuk ka prezent
- Të tjerë:** Z. Dh. Zguro (Qëndresa Qytetare), znj. S. Selimi,
z. P. Çunge, znj. A. Hyka

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë për shqyrtimin administrativ nr.3 të organizatës “Qëndresa Qytetare”.

Znj. P. Doçaj: Ky denoncim është regjistruar me numrin 3 në regjistrin e denoncimeve. Denoncues është organizata “Qëndresa Qytetare”, subjekti i denoncuar janë: Drejtori i Shërbimit Spitalor Tepelenë, Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Kolonjë, Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, Drejtori i Spitalit Bashkiak Tropojë, Drejtori i Spitalit Bashkiak Delvinë, Drejtori i Spitalit Bashkiak Pukë, Drejtori i Spitalit Bashkiak Kolonjë, Drejtori i Qendrës Shëndetësore Paskuqan, Drejtori i Qendrës Shëndetësore Bregu i Lumit, Partia Socialiste e Shqipërisë. Objekti i denoncimit ka të bëjë me konstatimin e përdorimit të burimeve publike për qëllime zgjedhore, përkatësisht përdorimi i rrjetit social facebook, në faqen zyrtare të këtij institucioni për të kryer postime, ripostime

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

dhe pëlqime të Ministrisë së Shëndetësisë. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me faktin se në këto faqe të institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë dhe drejtoritë e shërbimit spitalor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, spitalet bashkiake dhe qendrat shëndetësore janë të angazhuar me shpërndarjen e postimeve që janë tërësisht me përmbajtje politike sipas denoncuesit. Nga ana e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 5.02.25, me vendimin nr. 65 ka nisur hetimin administrativ ndaj të gjitha institucioneve. Në datën 4.02.2025 nëpërmjet adresës së emailit, titullarët e këtyre institucioneve kanë depozituar prapësime brenda afatit ligjor të lënë nga ana jonë. Konkretisht, Drejtori i Qendrës Shëndetësore Paskuqan, Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, të Kujdesit Shëndetësor Kolonjë, Drejtori i Shërbimit Spitalor Tepelenë, Drejtori i Spitalit Delvinë dhe i Spitalit Pukë kanë depozituar pretendimet dhe pretendimi i tyre thuajse i njëjtë, ka të bëjë me faktin se janë bërë pa qëllim dhe i kanë korigjuar menjëherë duke siguruar që situata të mos përsëritet, pra i kanë fshirë të gjitha postimet dhe ripostimet në faqen e tyre. Nuk kemi administruar ende një përgjigje për sa i përket Drejtorit të Spitalit të Bashkisë Tropojë, të Spitalit të Bashkisë Kolonjë dhe Drejtorit të Qendrës Shëndetësore Bregu i Lumit, nuk kanë sjellë pretendime. I kemi njoftuar palët dhe kemi prezent sot Drejtorin e Shërbimit Spitalor të Tepelenës, Drejtorin e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Kolonjë dhe Drejtorin e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Znj. P. Doçaj: Po kështu prezent është dhe denoncuesi.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i “Qëndresa Qytetare”, besoj keni ndonjë gjë për të shtuar, jo?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Përshëndetje i nderuar! Sikundërse u citua, nga ana jonë janë denoncuar 9 institucione të Kujdesit Shëndetësor, në varësi të strukturës hierarkike, qoftë drejtori shërbimi spitalor, qoftë njësi të kujdesit shëndetësor apo spitale bashkiake dhe qendra shëndetësore, pasi është konstatuar nga ana jonë që këto institucione të kujdesit shëndetësor kanë shpërndarë në mënyrë konsistente postime me përmbajtje elektorale, të cilat janë vendosur në dispozicion Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në cilësinë e provave, duke shpërndarë postime për këtë rast Kongresit Rinor të Partisë Socialiste apo postime të tjera që identifikojnë ndër të tjera logon e një partie politike, siç është Partia Socialiste. Krahas kësaj, pasi jemi njohur edhe me parashtrimet ose me prapësimet e institucioneve të denoncuara, ndonëse institucionet pjesa më e madhe e tyre pretendojnë që kemi të bëjmë me gabime duke i pasur ose duke qenë se institucionet ose përfaqësuesi që administrojnë rrjetet sociale ka kujtuar se është duke vepruar në rrjetin e tij social dhe janë konstatuar të paktën në këto pretendime se rastet e denoncuara nga ana e “Qëndresës Qytetare” janë të vetmet raste. Në fakt me një kërkim të thjeshtë mund të shikohet që përveç postimeve, të cilat janë postime që janë bërë dhe janë sjellë në cilësinë e denoncimeve, postimet kanë vazhduar edhe pas denoncimit tonë, duke shpërndarë postime të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat ndonëse nuk i identifikojmë, le të themi qartë logon e Partisë Socialiste siç kemi pasur raste të tjera, identifikojnë slogane të kësaj force politike si: “Shqipëria 2030” apo “Shëndetësia që duam” dhe slogane të tjera që lidhen me përmbajtje elektorale. Mund të vë në dispozicion për shembull, të në prej qendrave shëndetësore, megjithatë të gjithë institucionet nga një verifikim që unë, sapo bëra tani rezulton që

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

kanë vijuar të shpërndajnë këto postime. Qëllimi në vetvete i këtij denoncimi është sikundër duke mbajtur në konsideratë dhe faktin që institucionet arsimore të denoncuara më parë nga qendra “Qëndresa Qytetare” kanë shpërndarë dhe vijnë të shpërndajnë në mënyrë konsistente postime. Qëllimi i këtij kallëzimi dhe çfarë ne kërkojmë përveç marrjes së masave administrative në ato raste që do të vlerësohet e nevojshme nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe veçanarisht për institucione nuk kanë ose më saktë kanë refuzuar të bashkëpunojnë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ne do të kërkonim nga ana e Komisionerit për marrjen e një vendimi me karakter të përgjithshëm për të ndaluar ripostimet nga të gjitha institucionet, pavarësisht natyrës së tyre, të titullarëve, duke qenë se kemi të bëjmë me postime veçanarisht me përmbajtje politike dhe është shumë e vështirë për të dalluar ndonjëherë se cilat janë këto postime që nuk janë politike. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, dakord, vazhdojmë sipas radhës. Vetëm ju lutem prezantohuni, kë përfaqësoni.

Znj. S. Selimi, Drejtore e Spitalit Tepelenë: Përshëndetje! Unë jam Suela Selimi, Drejtoreshë e Spitalit Tepelenë. Mendoj se nuk kam çfarë të shtoj më shumë mbi prapësimet që kam bërë, që personi i autorizuar i institucionit tonë, ku pasqyron veprimtarinë e shëndetësisë e ka bërë pa qëllim, duke e quajtur vazhdimësinë e postimeve në fushën e shëndetësisë. Nuk mendoj që kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar.

Z. I. Celibashi: Dakord. Po, zotëria tjetër ju lutem.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

Z. P. Çunge, Drejtor, i NJ.V.K.SH, Kolonjë: Përshëndetje, Pando Çunge, Drejtor i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Kolonjë. I nderuar zoti Komisioner! Fillimisht ju kërkohet ndjesë për këtë situatë! Nga provat bashkëngjitur nga 23 prova, ne përfshihemi në dy prova, prova nr. 9 dhe prova nr. 21. Nga ana ime theksohet se ky fakt u mësua shumë vonë dhe që nga ai moment postimet e shpërndara nga kjo faqe janë fshirë dhe nuk ekzistojnë më. Dua të theksoj se këto dy raste janë të veçuara, pasi janë bërë gabim nga punonjësi që administron faqen zyrtare të institucionit, pasi ka menduar se ishte në faqen etij personale. Me këto postime vërtet janë bërë shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, por mendoj se ky është një gabim njerëzor dhe nuk është qëllim në vetvete për të përdorur burimet publike në mbështetje të subjekte zgjedhore. Në rastet në fjalë, pavarësisht se janë sporadike duhet të mos kishin ndodhur, ashtu siç e citova më lart është bërë një gabim njerëzor nga punonjësi që administron faqen zyrtare të institucionit. Mendoj se këto dy postime nga faqja zyrtare e Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kolonjë, nuk mund të ndikojnë apo të japin ndonjë mbështetje të madhe kandidatëve në Tiranë. Vetë personalisht ndjehem në faj pasi këto raste sporadike nuk janë bërë apo nuk janë urdhëruar nga ana ime dhe premtoj që kjo situatë nuk ka për të ndodhur më. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Zonja tjetër, nga Durrësi.

Znj. A. Hyka, Drejtore e NJ.V.K.SH, Durrës: Mirëdita i nderuar! Aurora Hyka, Drejtore e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Në kuadër të të gjithë aktivitetit që ushtron njësia vendore për pjesën e promovimit të aktivitetit të ministrisë apo të institucioneve të linjës, aktiviteti për shpërndarjen apo pëlqimet sa i përket materialeve të paraqitura nga “Qëndresa Qytetare”, patjetër që janë bërë nga ana

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

jonë, por kjo është marrë në konsideratë dhe në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, duke qenë se fushata zgjedhore fillon 30 ditë para dhe kjo që nuk është vlerësuar në syrin tonë që jemi duke bërë një gabim apo jo dhe në mbështetje të këtij neni ka vazhduar gjithë aktiviteti, patjetër që në gjithë materialet nuk është se nuk janë trajtuar materialet, të cilat janë thirrje politike apo elektorale. Për pjesën e një fryme bashkëpunimi apo zbatimi të ligjit dhe nga ana jonë janë marrë masa për fshirjen e materialeve të postuara apo të ripostuara. Kështu që i gjithë aktiviteti është bazuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, përpos pjesës tjetër të materialit prapësime që kam paraqitur. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Të tjera nuk kemi, jo? Mirë, patjetër që është garanci thuajse edhe nga ato çfarë keni paraqitur ju apo të tjerët si prapësime në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, po dhe nga çfarë deklaruar këtu që është kuptuar paligjshmëria e veprimit të postimit atyre përmbajtjeve. Shpresojmë që edhe ata të cilët nuk janë pjesë e këtij shqyrtimi administrativ ta kenë kuptuar këtë në vijim. Gjithsesi në lidhje me vendimin që do të marrim për këtë rast ju do të njoftoheni në ditët në vijim. Kemi adresat zyrtare të emailit të gjithësecilit prej tyre për t'ju njoftuar vendimin e Komisionerit. Do të vlerësojmë çfarë thatë sot, çfarë përmbajnë prapësimet tuaja dhe do të vendosim në lidhje me këtë çështje, dakord. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

11.02.2025

Ora 15:20

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin nr. 4, datë 06.02.2025 të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. I. Osmanaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: Kuvendi i Shqipërisë: znj. M. Arbi. Znj. E. Domi.

KRIIK

Z. I. Celibashi: Atëherë kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me denoncimin e KRIIK-ut.

Znj. P. Doçaj: Denoncimi me nr. 4 i regjistruar në regjistrin e denoncimeve. Denoncues është KRIIK, subjekti i denoncuar zonja Elisa Spiropali, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, zoti Engjëll Agaçi në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, objekti i denoncimit ka të bëjë me miratimin e një projektvendimi “Për një shtesë në ligjin 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar që bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor sipas objektit të denoncimit. Pretendimet e denoncuesit në seancën plenare të datës 30 janar 2025 Kuvendi i

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

Shqipërisë ka miratuar me 70 vota “pro” projektligjin “Për një shtesë në ligjin 29/2023” që ka të bëjë me miratimin mbi të ardhurat. Nga konsultimi i faqes zyrtare në internet të Presidentit të Republikës si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare vërehet se ky projektvendim nuk është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe as botuar në fletoren zyrtare. Kjo për sa i përket pretendimeve të denoncuesit. Nëpërmjet vendimit nr. 75, datë 10.02.2025 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur fillimin e hetimit administrativ në lidhje me këtë denoncim. Në datën 11.02. 2025 kemi administruar pretendimet e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Kryeministri, të cilët shprehen si vijon: “Kuvendi i Shqipërisë me një shkresë i ka dërguar për mendim Këshillit të Ministrave projektvendimin”, objekt i këtij denoncimi Kuvendi pretendon se bazuar pikën 2 të nenit 82 të Kushtetutës parashikohet se asnjë projektligj qeveritar që bën të nevojshëm rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit apo të pakësojë të ardhurat nuk do të mund të miratohet pa mendimin e Këshillit të Ministrave. Këtë ka bërë Kuvendi ia ka dërguar Këshillit të Ministrave, pasi ka marrë mendimin e Këshillit të Ministrave ka proceduar me miratimin e tij. Në datën 11.02.2025 kemi administruar dhe pretendimet e Kuvendit, të cilët shprehen se ky projektvendim i miratuar nga ana e tyre nuk ka një natyrë kufizuese dhe përfituese dhe për këtë motiv nuk bie në kundërshtim me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Kemi administruar në kuadër të këtij denoncimi, kemi nisur dhe kemi bërë një shqyrtim të gjithë listës së projektvendimeve të përfshira në kalendarin e Kuvendit të Shqipërisë për periudhën nga 2 shkurti e vijues, kemi konstatuar se ka dy projektligje të cilat nuk do të duhet të miratoheshin pasi parashikojnë lehtësira fiskale dhe mund të bien ndesh me parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht është projektligji për paketën e maleve, ku listohen disa procedura fiskale për të ndihmuar ekonominë malore dhe projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07, për tatimin

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë. Këto janë dy nga ato projektligje të cilat nuk do të duhen të miratohen edhe nëse janë pjesë e kalendarit të Kuvendit.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me atë denoncimin e KRIIK-ut projektligji ka kaluar, është, kemi dhe përfaqësuesit e Kuvendit, ka kaluar dhe është për dekretim nga Presidenti i Republikës, ka kaluar në seancë është miratuar.

Znj. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: I nderuar Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve! Ne jemi denocuar nga koalicioni KRIIK në lidhje me një ligj të miratuar, ligji 9/2025, i miratuar në seancën plenare të datës 30.01.2025 nga Kuvendi i Shqipërisë, ligj i cili aktualisht është në procedurën dhe në afatet e të drejtës që ka Presidenti i Republikës, referuar nenit 84, të Kushtetutës për dekretimin e tij dhe shpalljen, hyrjen e tij në fuqi të kushtetutës për dekretimin e tij dhe shpalljen dhe hyrjen në fuqi. Në lidhje me sa pretendohet, Kuvendi mban qëndrimin që nuk jemi në ato kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, konkretisht në nenin 91, pika 4 të tij, mbi bazën e të cilave Kuvendi nuk duhet ta fuste as në kalendar, as në procesin e shqyrtimit nëpër komisione dhe të miratimit më pas në seancë plenare. Ku fokusohemi dhe ku e mbështesim këtë pretendim ne si Kuvend në lidhje me denoncimin që është bërë, pranë jush? Së pari, nëse do t'i referohemi vetë përmbajtjes edhe në leximin literal, por dhe në kontekst, përmbajtjes së nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor në fuqi, ajo bën fjalë se “Katër muaj para ditës së zgjedhjeve, deri në formimin e qeverisë së re, pas zgjedhjeve, ndalohet propozimi, miratimi, ose nxjerrja e akteve ligjore/nënligjore, të cilat parashikojnë përfitime për një kategori të caktuar të popullsisë...”. Pra, e thekson këtë, “të popullsisë”. “...të cilat si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjen ekonomike, apo sociale, uljen apo heqjen e taksave, vendosjen e amnistisë fiskale, privatizimit,

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

apo dhënies së pasurive apo të shpërblimeve, etj., përveç kur nisma kushtëzohet nga gjendja e fatkeqësisë natyrore”. Natyrisht nuk jemi në kushtet ku nisma favorizohet prej gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Por, nuk jemi as në kushtet ku ky ligj favorizon një kategori të caktuar të popullsisë. Pse Kuvendi mori këtë nismë dhe e futi në procedura shqyrtimi? Nëse i referohemi pikës 1, shkronja b të nenit 69, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, bëhet fjalë për të përjashtuar entet që operojnë në strukturat akomoduese hotel-resort me katër dhe pesë yje. Status special, sipas përcaktimit të legjislacionit në fushën e turizmit dhe që janë mbartës të një marke tregtare të regjistruar të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10 vjeçare. Për ato struktura që fitojnë statusin special në dhjetor 2026, efektet e përjashtimit fillojnë nga momenti i fillimit të veprimtarisë ekonomike të këtyre strukturave akomoduese, por jo më vonë se 5 vjet nga marrja e këtij statusi special. Pra, nëse do t’i referohemi kontekstit dhe përmbajtjes së ligjit të miratuar nga Kuvendi nuk përkon dhe nuk përfshihet në ndalimet e parashikuara në nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, e cila është reflektuar më pas edhe në vendimin nr. 9 të 2020-s të ndryshuar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Fakti që nuk përfshihet... edhe në këtë analizë ose në këtë krahasim që i bëjmë dispozitës së miratuar, dmth ligjit të miratuar dhe frymës që kërkon Kodi Zgjedhor, pra kërkon një popullatë dhe jo për gjithsej 11 brande, 11 hotele me 5 yje që kanë këtë status, pra jo yjet që vendosin hotelet sot në Shqipëri, por ato hotele që e kanë vërtet këtë status. Pra, nuk përbëjnë popullatë, nuk përbëjnë grup të caktuar interesi në kuptim të nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Nisemi edhe nga fakti i.., pra mungon ai qëllimi për të avantazhuar një grup të caktuar për çështje elektorale. Dispozita e miratuar nga Kuvendi me ligjin 9/2025 “Për një shtesë në ligjin 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, nuk krijon asnjë formë as të drejtë për drejtë, as të tërthortë të lehtësimit fiskal të popullatës së gjerë, apo të një kategorie

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

votuesish të cilët mund të ndikojnë në zgjedhje. Përkundrazi përfituesit e këtij ndryshimi janë një kategori shumë e kufizuar, të cilët nuk mund të kenë as ndikim, as impakt në procesin zgjedhor. Qëllimi pse është bërë? Qëllimi është nxitja e turizimit. Zgjedhjet janë në 11 maj. Sezoni turistik fillon në atë kohë. Në qëllimin e politikave të qeverisë shqiptare, por të mbështetur edhe nga Kuvendi i Shqipërisë edhe me nismën e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë është favorizimi dhe zhvillimi i turizmit. Favorizimi dhe zhvillimi i turizmit bëhet që të ofrojë resurse për të bërë hotele të këtyre brandeve. Pra, brande të njohur ndërkombëtarisht. Momentalisht ligji duhet të hyjë në fuqi dhe të shtrijë efektet në momentin që këto brande do të vijnë dhe do të ofrohen për të ndërtuar degët, ose filialet e tyre dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra, nuk ka lidhje të drejtë për drejtë, as me procesin zgjedhor, as me impaktin që do të japë ky ligj i miratuar në këtë proces zgjedhor. Fakti është që mungojnë pikërisht ato që lexova, efektet e menjëhershme të zbatimit të këtij ligji. Pra, ky i shtrin efektet kur fitojnë statusin special deri në dhjetor të 2026-ës. Nga momenti i fillimit dhe jo më vonë se 5 vjet nga marrja e statusit special. Pra, edhe momenti kohor nuk lidhet me momentin në të cilin zhvillohet fushata zgjedhore apo është ndalimi zgjedhor i parashikuar në Kodin Zgjedhor. Po kështu, edhe nëse do t'i referohemi jurisprudencës së Kodit Zgjedhor dhe vetë praktikave administrative të KQZ-së, standardit ndërkombëtar të OSBE/ODIHR, ne vlerësojmë që ligji nuk çënon asnjë nga këto standarde. As jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor, as praktikën e KQZ-së dhe as rekomandimet e OSBE/ODHIR, në lidhje me procesin zgjedhor dhe fushatat zgjedhore. Ajo ç'ka duhet të theksoj është që denoncuesit, pretendonin edhe për efektin financiar dhe thonin është i pallogaritur. Vërtet, kur kemi një nismë deputetësh. neni 82 i Kushtetutës, e detyron Kuvendin t'i drejtohet Këshillit të Ministrave, t'i marrë mendim për efektin financiar. Natyrisht Këshilli i Ministrave ka dhënë mendimin

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

dhe opinionin e tij, para se ligjit të shqyrtohet në Komision dhe më pas të miratohet në seancë plenare. Në kontekstin e pretendimeve që ngre kërkuesi, ato nuk janë çështje, nëse pretendojnë që qëndrojnë, nuk janë çështje që i takojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por është çështje që lidhet me përputhshmërinë me Kushtetutën dhe dispozitat kushtetuse. Mund të jetë Gjykata Kushtetuese nëse kërkuesit do të shkojnë të bëjnë kërkesë në lidhje me ligjshmërinë, përputhshmërinë e këtij ligji me parimet kushtetuese, ose me dispozitë konkrete kushtetuese. Por jo, në kontekstin e shkeljes së nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor e reflektuar kjo në vendimin 9/2020, të ndryshuar, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këto ishin pretendimet që ka Kuvendi në lidhje me këtë. Përsa i përket dy ligjeve që zonja ju referua kalendarit. Ato janë përfshirë në kalendar, por nuk janë bërë akoma pjesë e procesit të shqyrtimit në Kuvend dhe do të jetë vendimarrja e Kuvendit normal, do të vlerësojë nëse duhet të përfshihen dhe duhet të vazhdojnë procesin e shqyrtimit apo jo. Deri tani, ato nuk janë në fazë shqyrtimi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi gjë tjetër?

Znj. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Jo! Flas për dy nismat. Ato ishin përfshirë vërtet në kalendar por nuk kanë marrë vulën e Kuvendit, nuk janë miratuar nga Kuvendi nga seanca plenare, ajo që në fund të fundit ka vendimarrjen për të miratuar një ligj apo jo.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Znj. Ervina Domi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: A mund të shtojmë diçka?

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

Z. I. Celibashi: Po

Znj. Ervina Domi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Në lidhje me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin mbi tatimin, mbi vlerën e shtuar”, që është propozim i zotit Braçe, do të doja të theksoja në fakt që nuk ka as edhe një impakt financiar. Ky projektligj në thelb nuk ofron lehtësira fiskale, por thjesht kthimin në normalitet të tatimit mbi vlerën e shtuar. Kjo do të thotë, ka barazuar skemën 20:20 për çdo njeri të popullatës shqiptare. Kështu në thelb edhe nëse do të fillojë shqyrtimi, ne vlerësojmë që nuk jemi aspak në kushtet e ndalesës të nenit 91, pika 4.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Në lidhje me çfarë u argumentua nga ana juaj dhe në lidhje me atë çfarë është pretenduar nga organizata KRIIK, unë vlerësoj që argumentet tuaja në lidhje me atë projektligj, nuk qëndrojnë në kuptim të momentit kur projektligji prodhon efektet financiare. Neni 91 nuk e ka lidhur me momentin kur prodhohen efektet financiare të një akti. E ka lidhur me miratimin e këtij akti. Pra, akti në vetvete mund t’i prodhojë efektet pas nje viti, pas dy, apo tre vjetësh, mbas 5, apo gjashtë vjetësh, pak a shumë sikurse është rasti i atij projektligji, ligjit tashmë të miratuar. E para, dhe e dyta edhe përsa i përket kategorisë. Në vlerësimin tim ndalimi nuk është thjesht dhe vetëm për personat fizikë, pra për individët, sepse i bie që, në rastet e privatizimeve sikurse është parashikuar në nenin 91. Privatizimet bazuar në argumentin tuaj, duket sikur privatizimet e kryera nga subjektet juridike janë të lejuara gjatë kësaj periudhe. Pra, të nisen dhe të përfundojnë, ndërkohë që nuk është kështu në gjykimin dhe vlerësimin tim. Por, ka një argument tjetër ligjor, i cili e rrëzon kërkesën e organizatës KRIIK. Ky tashmë është një ligj, e ka kaluar procesin e shqyrtimit, është miratuar dhe është në tavolinën e Presidentit të

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

Republikës për t'u dekretuar. Në interpretim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, ndaj të cilave ne si institucion jemi të obliguar në mënyrë parësore për t'i zbatuar nuk ka ndalime, për Presidentin e Republikës për dekretimin dhe për t'i dhënë fuqi, të themi, një ligji të caktuar dhe ka logjikë, sepse Presidenti i Republikës mund të mos shprehet brenda afatit të caktuar dhe ligji hyn në fuqi. Ne nuk mund., bazuar në atë që thotë ligji, ta detyrojmë Presidentin e Republikës, ti themi që "shiko...". Ja nuk do ta dekretojë dhe automatikisht do të hyj ligji në fuqi. Ne nuk e ndalojmë dot këtë afat, sepse këtë e ka përcaktuar Kushtetuta. Kështu që mekanizmi i prodhimit të efekteve të një ligji, ka përfunduar në momentin kur është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, përndryshe nëse Presidenti i Republikës e kthen. Kështu që, për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve...

Znj. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kuvendit të Shqipërisë: Dakord, por qëllimi ishte që bëhet fjalë për 11 brande, nuk bëhet fjalë për 11 subjekte...

Z. I. Celibashi: Të lutem se ju, e keni këtë ekspëriencën e KQZ-së. Mbaruam me këtë i dhatë argumentet tuaja, që kështu nuk ka rëndësi. Nuk e debatojmë këtë tani. Për këtë arsye të fundit, që unë relatova nuk gjen vend për t'u pranuar kërkesa e organizatës KRIIK. Ai ligj tashmë varet nga Presidenti i Republikës. Nëse do ta rikthejë Presidenti i Republikës, atëherë jemi në diskutim tjetër. Përsa i përket dy projektligjeve të tjera, ai i titulluar "Për paketën e maleve", dhe ai që ka të bëjë "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92 datë 24.07.2014", do t'i kërkoj Kuvendit të Shqipërisë të mos e përfshijë në shqyrtim në seancë plenare. Të mos i përfshijë këto dy projektligje. Në gjykimin dhe në vlerësimin tim, shqyrtimi i këtyre dy projektligjeve, vjen në kundërshti me parashikimet e nenit 91. Jo më kot e paraqes këtë si kërkesë, se në fund të fundit, Kuvendi i Shqipërisë është sovran dhe askush,

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

asnjë institucion dhe aq më pak Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk mund t'i imponojë vendimmarrjen. Por, ama jam brenda tagrave të ligjit për t'ia kërkuar këtë Kuvendit të Shqipërisë, që të mos i përfshijë në seancë plenare këto dy projektligje. Besoj që ka argument të plotë, bazuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

Vendim nr. 83

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

11.02.2025

Ora 15:38

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 2 deri më 9 shkurt 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. I. Osmanaj.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Znj. L. Veliu: Në kuadër të procesit të monitorimit që ka nisur në datë 11 janar dhe do të vazhdojw deri në ditën e zgjedhjeve, nga ana e monitoruesve janë dërguar 3 raporte monitorimi, të cilat gjenden të publikuara edhe në faqen zyrtare të KQZ-së. Për periudhën 2 - 9 shkurt, janë përcjellë në total 96 raporte monitorimi dhe nga administrimi dhe shqyrtimi i tyre për periudhën kohore të lartpërmendur nuk është konstatuar asnjë shkelje që bie ndesh me parashikimet ligjore.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

11.02.2025

Ora 15:39

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë,
me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e
Shqipërisë”, zonjën Ana Harallamb Papadhimitri”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. I. Osmanaj.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë.

Znj. L. Veliu: Këshilli Bashkisë Gjirokastrë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari zonja Ardita Koçollari, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë të cilit i kalon mandati i këshilltarit është zonja Ana Papadhimitri. KQZ i është drejtuar kandidatit me kërkesë për plotësim dokumentacioni, i cili është plotësuar dhe depozituar pranë KQZ. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton që Ana Papadhimitri nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që lidhet me parashikimin për ndalim në ligjin 138/2015. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 11.02.2025*

dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar një informacion ku konstatohet që kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar informacion ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në përfundim rezulton se të dhënat e administruara nuk përbëjnë kushtë për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshillarit. Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Ana Papadhimitri”.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gjirokastrë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zonjën Ana Papadhimitri.

Çështje të tjera nuk kemi në rend dite. Faleminderit! Seanca mbyllet.

Vendim nr. 63

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*

